



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:082153

Datë: 21.06.2022

Numri i dokumentit: 03156838

C. nr.578/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Durim Balaj, në çështjen kontestimore të paditëses D. A. nga Gjakova, fshati O.H., të cilën e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 894,60 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur me datë 15 prill 2022, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 21 qershor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses D. A. nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit (70% të biletës së transportit), për periudhën kohore nga data 08.04.2019 deri me datë 28.02.2021, gjegjësisht për 426 ditë të punës, t'ia kompensojë shumën prej 894,60 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 27.04.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 259.20 euro, e gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka parashtruar se e njëjta është e punësuar në SHFMU "A. Rr.", në fshatin B., Komuna Gjakovë, pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë. Ka shtuar se në bazë të nenit 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 18.04.2017 dhe nenit 35, pika 5 të Kontratës

Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, i takon kompensimi i 70% të shpenzimeve të udhëtimit për destinacionin nga vendbanimi i saj deri në vendin e punës. Ka shtuar se paditëses për periudhën kohore nga data 08.04.2019 e deri me datë 28.02.2021, për 426 ditë i takon shuma prej 894,00 euro. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë : për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në lartësinë prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë vlerën prej 104,00 euro, si dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë prej 135,20 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 259,20 euro.

E paditura Komuna e Gjakovës, për datën dhe kohën e seancës ka qenë e njoftuar, siç vërtetohet nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës, të cilën e ka pranuar me datë 16.05.2022, mirëpo e njëjta nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën e saj nuk e ka paralajmëruar dhe justifikuar në asnjë mënyrë, andaj Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të te paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: kontratën e punës me nr. prot. ..., datë 01.09.2020, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës; vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve, për relacionin Gjakovë-O. H., gjegjësisht Gjakovë Zh.; vërtetimin për ditët e prezencës në punë të datës 08.03.2021, i lëshuar nga SHFMU “A. Rr.” – B., Gjakovë; biletën e autobusit, të datës 04.03.2021, me numër, i lëshuar nga “A. T.” Gjakovë; si dhe certifikata e vendbanimit me numër serik, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë-B., me datë 05.03.2021.

Nga provat e zbatuara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga kontrata e punës me nr. prot. ..., datë 01.09.2020, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës, vërtetohet se këtu paditësja D. A., në cilësinë e mësimdhënëses punon në shkollën “A. Rr.” – B., Gjakovë dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është nga data 01.09.2020 – e përhershme

Nga vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve, vërtetohet se çmimi i biletës për relacionin Gjakovë-O. H., në një drejtim është në shumë prej 0,50 cent, ndërsa për relacionin Gjakovë-Zh., çmimi i biletës është në shumë prej 1,00 euro në një drejtim.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë të datës 08.03.2021, i lëshuar nga SHFMU “A. Rr.” – B., Gjakovë, vërtetohet se paditësja nga data 08.04.2019 e deri më datë 28.02.2021, ka gjithsejtë 426 ditë të punës.

Nga certifikata e vendbanimit me numër serik, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë-B., me datë 05.03.2021, vërtetohet se e njëjta banon në fshatin O.H., komuna e Gjakovës.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, si dhe të datës 21.01.2021, në të cilën në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”,* erdhi në përfundim se paditëses i takon kompensimi i kërkuar për shpenzimet e udhëtimit, ngase me provat e lartcekura dhe atë nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë të datës 08.03.2021, i lëshuar nga SHFMU “A. Rr.” – B., Gjakovë u vërtetua se e njëjta përgjatë periudhës kohore nga data 08.04.2019 e deri me datë 28.02.2021, ka vijuar 426 ditë punë, ndërsa nga vërtetimi i shoqatës së transportit në Gjakovë, u provua se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Gjakovë-O. H., është 0,50 cent në një drejtim, ndërsa në dy drejtimet është në shumë prej 1,00 euro, ndërsa çmimi në relacionin Gjakovë-Zh., në një drejtim është në shumë prej 1,00 euro, ndërsa në dy drejtimet është 2,00 euro, e që llogaritur shuma prej 3,00 euro (shuma e përgjithshme e pagesës së biletës së transportit) me 70%, del të jetë në shumë prej 894,60 euro, duke bërë përlllogaritjen si në vijim: $426 \times 2,10 \text{ euro} = 894,60 \text{ euro}$.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*).

Për më tepër dispozita e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditores, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kamatën e gjykuar vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’rast paditëses iu pranuan shpenzimet siç më poshtë vijnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, dhe për pjesëmarrje në një seancë gjyqësore shumën prej 135,20 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 259,20 euro.

Nga te lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.578/21, me 21 qershor 2022

G J Y Q T A R I,

Durim Balaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.